

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA MALISHEVË, divizioni civil/civile, me gjyqtarin Haki Kryeziu si dhe sekretarja juridike Fatime Hoti, në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, ndaj të paditurit F. S. Z. nga fshati N., komuna e Malishevës, lidhur me rimbursimin e dëmit në shumë prej 416.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datën **25.09.2017** muar:

A K T G J Y K I M **PËR SHKAK TË PADËGJUSHMËRISË**

I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, **si e bazuar .**

II. Detyrohet i padituri F. Z. nga fshati N., Komuna e Malishevës, t`ia paguaj paditësit Kompanisë së Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, në emër të rimbursimit të dëmit shumë prej 416.00 euro, me kamatë ligjore nga data 04.07.2013 deri në pagesën definitive si dhe taksat gjyqësore për parashtrimin e padisë në shumë prej 15.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, me datën 28.12.2015 pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi ndaj të paditurit F. Z. nga fshati N., komuna e Malishevës, lidhur me rimbursimin e dëmit të shkaktuar në aksident të komunikacion duke shkaktuar dëme të dëmtuarit F. H. nga M.. I padituri me rastin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa patentë shofer ndërsa i dëmtuari kërkesën pasurore juridike e ka realizuar te paditësja në shumë e përgjithshme prej 416.00 euro. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar dhe të detyrohet i padituri që paditësit t`ia rimburoj shumë prej 416.00 euro, me kamatë ligjore nga data 04.07.2013 si dhe shumë prej 15.00 euro në emër të taksave gjyqësore.

Gjykata përmes aktvendimit e ka njoftuar të paditurin me të drejtën e parashtrimit të përgjigjes në padi. I padituri edhe pse ka pranuar aktvendimin mbi përgjigjen në padi , nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

Gjykata në bazë të nenit 150 të Ligjit për Procedurën Kontestimore konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmëris.

Sipas nenit 150 par.1,pika a, b, dhe c të LPK-së thuhet se në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilën e aprovon kërkesëpadinë , poqese plotësohen kushtet dhe atë: kur të paditurit i është dorëzuar padia si dhe thirrja (aktvendimi) për dhënien e përgjigjes në padi, poqese themelësia e kërkesëpadiisë del nga faktet e treguara në padi dhe poqese faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar paditësi apo në faktet e ditura botërisht.

Gjykata ka vlerësuar provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i aksidentit me nr.-...-.... i datës 06.04.2012, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë C.nr.338/2015 i datës 19.04.2017, konfirmimi i pagesës nga banka i dt.04.07.2013.

Gjykata pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresa të lëndës erdhi në përfundim së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe për këtë vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për shumë prej 416.00 euro me kamatë ligjore dhe shpenzimet për taksa gjyqësore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e shqyrtuara gjykata ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 150 i LPK-së për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë, për faktin se i padituri edhe pse ka pranuar aktvendimin mbi dhënien e përgjigjes në padi dhe është njoftuar mbi pasojat e mos dhënies së përgjigjes në padi në bazë të nenit 395 par.2 të LPK-së të njëjtën nuk e ka ushtruar.

Gjykata ka konstatuar se nuk ka pengesa për dhënien e aktgjykimit në bazë të pa dëgjueshmërisë nga neni 3 par.3 i Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Me sa u tha më lartë ,u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 150 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-dega Malishevë
C.nr.338/2015, më datën: 25.09.2017

Gj y q t a r i
Haki Kryeziu

UDHËZIM JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.